



ACFC/INF/OP/I(2003)004  
Albanian version

**ADVISORY COMMITTEE ON THE FRAMEWORK CONVENTION  
FOR THE PROTECTION OF NATIONAL MINORITIES**

\_\_\_\_\_

**OPINION ON ALBANIA**

\_\_\_\_\_

## Permbledhje ekzekutive

Duke ndjekur raportin fillestar te Shqiperise me 26 Qershor 2001(nisur me 1 Janar 2001),Komiteti Keshillues filloi egzaminimin e raportit te shtetit ne mbledhjen e tij te 11-te me 10-14 Shtator 2001.

Ne kete kontekst te egzaminimit, nje delegacion i Komitetit Keshillues vizitoi Tiranen nga 29 Prill-3 Maj 2002, me qellimin qe te kerkoje informacion te metejshem mbi zbatimin e Konventes Kuader nga perfaqesues te qeverise si dhe te OJQ-ve dhe burimeve te tjera te pavarura. Komuniteti Keshillues adoptoi opinionin e tij mbi Shqiperine ne mbledhjen e tij te 15-te, me 12 Shtator 2002.

Persa i perket zbatimit te Konventes Kuader, Komiteti Keshillues mendon se Shqiperia ne shume aspekte ka bere perpjekje te admirueshme ne mbrojtje te minoriteteve kombetare, persa i perket fushes se arsimit dhe te kushteve te shkolles te greqishtes e maqedonishtes ne zona te banuara prej tyre.

Komiteti Keshillues thekson gjithashtu se nje fryme tolerance mbizoteron ne Shqiperi.

Pavaresisht nga adoptimi i disa garancive te rendesishme ligjore te disa nga ceshtjeve te Konventes Kuader,perpjekje te metejshme duhen bere per te plotesuar kuadrin ligjor dhe institucional dhe per te siguruar realizimin e tij te plote ne praktike.Nje kuader i qarte ligjor dhe administrative nevojitet qe te adaptohet per te perballuar nje numer pengesash ne lidhje me perdorimin e gjuhes se minoritetit me autoritetet administrative dhe perdorimin e emrave local tradicional, emrat e rrugeve dhe treguesve te tjere topografike.

Mungesa e te dhenave statistikore per minoritetet kombetare dhe ceshtjet qe qe prekin ato, jane nje pengese serioze per monitorimin dhe projektimin e politikave dhe praktikave ne raport me minoritetet kombetare.Komiteti Keshillues mendon se nje informacion i sakte statistikor i personave dhe vendbanimit te minoriteteve nepermjet nje numerimi zyrtar eshte e domosdoshme ne Shqiperi.Komiteti Keshillues thekson se pavaresisht nga prezenca historike e egjiptianeve ne Shqiperi, ato duket se kane qene perjashtuar nga mbrojtja parimore e Konventes Kuader.Kjo metode nuk pershtatet me Konventen Kuader dhe Komiteti Keshillues mendon se Qeveria shqiptare duhet qe ne bashkepunim me te interesuarit ne kete ceshtje te vazhdoje egzaminimin e saj te metejshem.

Masa te metejshme kerkohen te permisohen, ne vecanti ajo e transmetimit te radios dhe televizionit per personat qe u perkasin minoriteteve. Per me tej duhet qe te merren masa per te zgjeruar arsimimin ne gjuhen e minoritetit ku ka nevojte dhe kerkesa per minoritetin malazes,rom, vlleh dhe Maqedonas ne zona ku deri tashme nuk jane aplikuar.

Pavaresisht se ka plane per vendosjen e nje strategjie kombetare per romet akoma ka probleme per sa i perket komunitetit rom ne lidhje me diskriminimin dhe paragjykimin ndaj tyre. Pavaresisht nga disa ndryshime sociale, ka nje rritje te hendekut social-ekonomik midis tyre dhe pjeses tjeter te shoqerise.

Komiteti Keshillues eshte i interesuar per pjesemarrjen efektive te personave qe i perkasin minoriteteve ne jeten ekonomike dhe ne ceshtjet publike dhe ai eshte i mendimit se duhet bere nje analize per kete situatë qe duhet te pasohet nga ndermarrje te duhura sipas kushteve.

### **Komiteti Keshillues ne Konventen Kuader per Mbrojtjen e Minoriteteve.**

#### Opinione mbi Shqiperine

Permbajtja:

- Pergatitja e opinionit aktual
- Shenime te pergjithshme
- Komente specifike per artikujt 1-19
- Komentet dhe konkluzionet kryesore te Komitetit Keshillues
- Shenimet perfundimtare

#### Pergatitja e opinionit aktual

1. Raporti fillestar shteteror i Shqiperise (dhe me pas: Raporti Shteteror) dhene me 1 Janar 2001, u dorezua me 26 Qershor 2001. Komiteti Keshillues filloi egzaminimin mbi raportin e shtetit ne mbledhjen e tij te 11-te me 10-14 Shtator 2001.
2. Ne kete egzaminim Komiteti Keshillues percaktoi nje numer ceshtjesh qe duhet te kene informacion me te plote. Nje pyetsor iu dergua autoriteteve shqiptare me 4 Mars 2002. Nje pergjigje e pjesshme e ketij pyetsori u morr nga nje delegacion i Komitetit Keshillues gjate nje vizite ne Shqiperi (shih me poshte).
3. Me tej nga nje ftese e Qeverise shqiptare dhe ne perputhje me ligjin 32 te rezolutes se Komitetit te Ministrave (97) 10, nje delegacion i Komitetit Keshillues vizitoi Shqiperine nga 29 Prill deri me 3 Maj 2002 me qellim per te marre informacion te metejshem nga perfaqesues te qeverise, OJQ-ve dhe burimeve te tjera te pavarura, mbi zbatimin e Konventes Kuader. Ne

pergatitjen e ketij opinioni ,Komiteti Keshillues konsultoi gjithashtu nje sere materialesh te shkruara nga organizata te ndryshme te Keshillit te Europes, organizata te tjera nderkombetare,OJQ-ve dhe burimeve te tjera te pavarura.

4. Komiteti Keshillues me pas e adoptoi kete opinion ne mbledhjen e tij te 15-te, me 15 Shtator 2002 dhe vendosi t'ia dergoje ate Komitetit te Ministrave.

5. Opinioni i tanishem eshte hartuar duke u bazuar ne nenin 26(1) te Konventes Kuader sipas se cilit per vleresimin e masave te marra nga palet per zbatimin e parimeve te Konventes, “Komiteti i Ministrave duhet te asistohet nga nje Komitet Keshillues”, si dhe duke u bazuar ne ligjin 23 te rezolutes (97) 10 te Komitetit te Ministrave, sipas te cilit “Komiteti Keshillues duhet te marre ne konsiderate raportin e shtetit dhe duhet t'ia transmetoje opinionin e tij Komitetit te Ministrave.”

## II. Shenime te pergjithshme

6. Kur raporti perfundimtar i shtetit u dorezua me vonese, Komiteti Keshillues pershendeti perpjekjet e bera nga autoritetet shqiptare qe kane perfshire ne raport jo vetem legjislacionin por edhe praktikate perkatese te lidhura me aplikimin e Konventes Kuader. Komiteti Keshillues nenvizon se pavaresisht nga perpjekjet e autoriteteve shqiptare per te dhene sa me shume informacion qe eshte e mundur, sasia dhe cilesia e informacionit lidhur me minoritetet ne Shqiperi eshte e kufizuar.

7. Komiteti Keshillues mori nje pamje te plote te situates nga pyetsori i qeverise dhe nga vizita e lartepemendur ne Shqiperi. Informacioni shtese dhene nga qeveria dhe nga burimet e tjera, vecanerisht nga perfaqesuesit e minoriteteve, ishte teper i vlefshem vecanerisht me zbatimin e praktikave te normave perkatese. Komiteti Keshillues mendon se mbledhja gjate vizites ishte nje rast i shkelqyer per nje dialog direkt me burime te ndryshme. Keto mbledhje u zhvilluan jo vetem ne Tirane por edhe ne Gjirokaster, Himare dhe Fier. Komiteti Keshillues vuri re frymen e bashkepunimit shprehur nga autoritetet shqiptare gjate procesit qe coi ne perpunimin e ketij opinioni.

8. Komitetit Keshillues i vjen keq se pavaresisht nga materialet e OJQ-ve te perdorura per pergatitjen e raportit te shtetit, autoritet shqiptare nuk u konsultuan gjerisht me perfaqesuesit e minoriteteve kur pergatiten raportin e shteteve. Komiteti Keshillues shpreson se nje konsultim me i gjere do te zhvillohet ne te ardhmen.

9. Komiteti Keshillues nenvizon gjithashtu se ka ankesa nga personat qe i perkasin minoritetit mbi probleme te ndryshme qe autoritetet nuk u pergjigjen.Komiteti Keshillues mendon se autoritetet shqiptare duhet te

sigurojne qe ketyre kerkesave t'u jepet gjithmone nje pergjigje dhe per problemet qe ngrihen duhet te merren veprimet e duhura.

10. Komiteti Keshillues inkurajon qeverine te marre masat e duhura per te ndergjegjesuar opinionin per Konventen Kuader, raportin e saj sqarues dhe rregullat qe lidhen me monitorimin e saj ne nivel nderkombetar duke perfshire nje zgjerim te raportit te shtetit dhe dokumentave perkatese.

11. Komiteti Keshillues deshiron te theksoje se ne ekzaminimin e zbatimit te Konventes Kuader nga Shqiperia, ai ka marre parasysh veshtiresite ekonomike qe vendi vazhdon te kete. E ndergjegjshme per rendesine e kushteve social-ekonomike ne zbatimin e politikave dhe masave qe shpesh kane nevojte per burime te mjaftueshme financiare, Komiteti Keshillues gjithsesi pershendet perpjekjet e bera nga autoritet shqiptare ne zbatimin e Konventes Kuader.

12. Komiteti Keshillues eshte i mendimit se eshte shume e rendesishme per autoritetet shqiptare te mbledhin informacion te metejshem duke perfshire informacionin statistikor per minoritetet dhe ceshtjet qe i prekin ato. Ne kete drejtim Komiteti Keshillues eshte i shqetesuar per ndryshimin e madh ne statistika per numrin e personave qe i perkasin minoriteve. Keto shifra variojne nga 2% te popullsisse sipas burimeve qeveritare deri ne mbi 20% sipas burimeve te tjera. Komiteti Keshillues mendon se nje numerim kombetar i minoriteve duhet te sqaroje kete situatet statistikore dhe nje numerim i tille ne te njejten kohe do te krijoje mundesi qe te identifikohen personat qe u perkasin minoriteve. Duke pasur parasysh se numerimi i fundit u be ne 2001 dhe asnje pyetje ne lidhje me etniken ishte perfshire ne kete sondazh, Komiteti Keshillues mendon se duhen te merren hapa te metejshme per te mbledhur te dhena te sakta per minoritetet.

13. Komiteti Keshillues mendon se ne mbledhjen e ketyre te dhenave statistikore eshte e rendesishme se rezultatet do te interpretohen ne perputhje me zgjedhjen subjektive te personave ne lidhje me organizimin brenda nje grupi te caktuar. Eshte e te njejtes rendesie se e drejta per t'u zgjedhur, per t'u trajtuar apo jo si minoritar, duhet te zbatohet pavaresisht nga disavantazhet qe rezultojne nga kjo zgjedhje. Per me tej ne mbledjen e ketyre te dhenave autoritetet shqiptare duhet te kene ne mendje parimet qe permban rekomandimi nr.97 (18) i Keshillit te Ministrave ne lidhje me mbrojtjen e te dhenave te grumbulluara per qellime statistikore. Dhe se fundmi Komiteti Keshillues mendon se eshte e rendesishme se me personat qe u perkasin minoriteve duhet te behen konsultime paraprake qe cojne ne mbledhjen e ketyre informacioneve duke perfshire pyetje te ndryshme nese keto perfshihen ne sondazh apo ne statistika te tjera.

14. Ne pjesen e meposhtme te opinionit thuhet se ne nje numer artikujsh qe bazohen ne informacionin qe eshte aktualisht ne dispozicion te tij, Komiteti Keshillues mendon se zbatimi i artikullit per kete ceshtje, nuk ka nevojte per vezhgime specifike. Komiteti Keshillues deshiron te bej te qarte se kjo thenie do te thote se jane marre masat e nevojshme dhe se perpjekjet ne kete drejtim duhet te veniten. Ne fakt Komiteti Keshillues mendon se detyrimet qe rrjedhin nga Konventa Kuader kerkojne perpjekje te qendrueshme dhe te vazhdueshme nga autoritetet per te respektuar parimet dhe per te arritur qellimet e Konventes Kuader. Per me tej nje numer i konsiderueshem ceshtjesh shteterore, nen driten e hyrjes ne fuqi kohet e fundit te Konventes Kuader, duhet te konsiderohen te pranueshme ne kete faze, por nuk eshte e nevojshme te konsiderohet si e tille ne rrethet e metejshme te monitorimit. Dhe se fundmi mund te ndodhe qe ceshtjet, qe na shfaqen ne kete faze te trajtuara si pak shqetesuese me kalimin e kohes do te provohen se jane nenvleresuar.

### **III. Komete te vecanta ne lidhje me artikujt 1-19:**

#### Artikulli 1

15. Komiteti Keshillues veren se Shqiperia ka ratifikuar nje numer te madh instrumentash nderkombetar. Bazuar ne informacionet qe aktualisht ka ne dispozicionin e tij, Komiteti Keshillues mendon se zbatimi i ketij artikulli nuk çon ne nje vezhgim te metejshem te kesaj ceshtje.

#### Artikulli 2

**16. Bazuar ne informacionet qe disponon, Komiteti Keshillues mendon se zbatimi i ketij artikulli nuk ka nevojte per vezhgime te metejshme.**

#### Artikulli 3

17. Komiteti Keshillues nenvizon se ne mungese te nje perkufizimi ne vete Konventen Kuader, palet duhet te rishikojne sasine e te dhenave qe duhet t'i jepen Konventes Kuader per vendin e tyre. Pozicioni i Qeverise shqiptare eshte vleresuar se duhet te rezultoje ne kete egzaminim.

18. Ndersa Komiteti Keshillues veren nga njera ane se palet kane te drejten per te dhene sugjerimet e tyre ne perputhje me kushtet e vendeve te tyre nga ana tjerer keto sugjerime duhet te jene edhe ne perputhje me parimet e pergjithshme nderkombetare te paraqitura ne artikullin 3. Ne vecanti ai thekson se zbatimi i Konventes Kuader nuk duhet te jete nje tipar arbitrar dhe i pajustificueshem.

19. Per kete arsye Komiteti Keshillues mendon si pjese te detyres se tij, te verifikoje sugjerimet personale te dhena per zbatimin e kesaj Konvente me qellimin per te vertetuar nese nuk jane bere shkelje arbitrare ne kete drejtim. Per me teprer Komiteti mendon se duhet te verifikoje aplikacionet perkatese te parimeve baze te artikullit 3.

20. Komiteti Keshillues veren ne raportin e shtetit se autoritetet shqiptare njohin si minoritete kombetare ato greke, maqedonese dhe malazeze dhe persa i perket atyre rome dhe rumune(vllehe), ato njihen thjesht si minoritete gjuhesore. Komiteti Keshillues kupton se sipas qeverise, Konventa Kuader aplikohet njesoj per keto grupe te minoriteteve kombetare apo gjuhesore pa dallim dhe diskriminim. Ai kupton se zgjedhja e romeve dhe vlleheve si minoritete thjesht gjuhesore bazohet ne faktin se ato nuk kane shtet te tyre. Pavaresisht nga ky shpjegim Komiteti ka dijeni se disa anetare te ketyre komuniteteve jane te pakenaqur nga termi “minoritet gjuhesor“ i cili nuk reflekton elementet baze te identitetit te tyre qe shkon pertej nenteksit thjesht ‘gjuhesor’. Komiteti inkurajon qeverine ne konsultim me te interesuarit te riezaminoje ceshtjen e njohjes se romeve dhe vlleheve si minoritete gjuhesore ne kundersizim me minoritetet kombetare duke siguruar qe ne te njejten kohe ky dallim te mos ndikojte ne aplikimin e Koventes Kuader ndaj ketyre komuniteteve.

21. Komiteti veren se shume persona qe i perkasin komunitetit egjyptian e konsiderojne veten si nje minoritet kombetar qe dallohet si nga ai rom edhe shqipetar gjithashtu. Komiteti nenvizon ne kete drejtim se personat qe i perkasin ketij komuniteti e perkufizojne veten nga ‘bekgraundi’ i tyre etnik, nga rrenjet e tyre historike si pasardhes egjyptian dhe ne traditen dhe trashgimene e tyre kulturore. Komiteti Keshillues veren pretendimet e qeverise shqiptare se komuniteti egjyptian eshte i intergruar ne shoqerine shqiptare dhe anetaret e ketij komuniteti flasin vetem shqip dhe kane humbur prej kohesh gjuhen e tyre. Personat qe i perkasin ketij komuniteti gjithsesi ia kane bere te qarte Komitetit Keshillues se ata kerkojne te njihen si nje minoritet kombetar.

22. Komiteti Keshillues mendon se prezenca historike e egjyptianeve ne Shqiperi dhe deshira e personave qe i perkasin ketij grupi, te identifikohen si persona qe i perkasin nje minoriteti kombetar dhe e drejta e tyre per te pasur

‘bekgraundin’ e tyre etnik, historine, traditen dhe trashgimene e tyre kulturore, nuk mund te perjashtohet nga e drejta e tyre per aplikim personal ne Konventen Kuader. Komiteti mendon se nje perjashtim i kesaj te drejte bie ndesh me Konventen dhe inkurajon qeverine shqiptare qe te rikonsideroje, ne konsultim me te interesuarit, mundesine e njohjes se tyre si minoritet kombetar.

23. Komiteti Keshillues nenvizon gjithashtu se me perjashtim te komunitetit Egjyptian, qeveria shqiptare nuk ka dhene asnje informacion per ndonje grup etnik apo linguistik (nese ato rezultojne si qytetare apo jo-qytetare qe jetojne ne vend), te cilet nuk konsiderohen si minoritare kombetar. Komiteti beson se do te konsiderohej atje ku ka mundesi, perfshirja e personave qe u perkasin grupeve te tjera, qofshin edhe jo qytetare shqiptare brenda Konventes Kuader ne baze te artikullit, dhe mendon se autoritetet shqiptare duhet ta konsiderojne kete ceshtje ne bashkepunim me te interesuarit.

24. Komiteti nenvizon se, sipas qeverise minoritetet kombetare njihen dhe mbrohen ne te gjithe territorin e Republikes se Shqiperise pa ndonje kriter gjeografik. Ndersa ky mund te jete qendrimi zyrtar, Komiteti mendon se aplikimi i “zonave te minoritetit”, te cilat egzistonin para dhe gjate regjimit komunist, mbulon zona ku minoritetet kombetare kane jetuar tradicionalisht, kane pasur monedhen e tyre dhe vecanerisht kane patur mundesi te mesojne gjuhen e tyre ( shih me poshte artikullin 14). Komiteti Keshillues eshte i mendimit se duhet te ndermerren hapa drejt sigurimit, se nuk ka limit te se drejtes se personave qe i perkasin minoriteteve qe jetojne jashte te ashtuquajturave “zona te minoritetit” dhe eshte e rendesishme te sqarohet kjo ceshtje me te interesuarit ne rrethet qeveritare dhe nderqeveritare.

#### Artikulli 4

25. Komiteti Keshillues nenvizon se kushtetuta shqiptare ka vendosur parime baze te barabarta perpara ligjit(artikulli 18)dhe garanton liri dhe mosdiskriminim ne baze te races, besimit, perkatesise etnike,gjuhes, gjendjes shoqerore dhe prejardhjes.Keto parashikime se bashku me ato te ligjit kriminal, te se drejtes civile dhe te se drejtes kriminale, paraqesin elemente te rendesishem per nje trupe ligjvenese qe ka si qellim luften ndaj diskriminimit. Komiteti Keshillues mendon se ka akoma hapesira per zgjerimin e kuadrit legjislativ. Per shembull sipas sugjerimeve te Komisionit European kunder Racizmit dhe Intolerances, ne raportin e saj te ,dye per Shqiperine egziston mundesia per te percaktuar mbrojtje te motivuar nga ana



raciale si nje mbrojtje specifike dhe ne menyre kategorike te mundesohet qe motivimi racor te merret parasysh si nje faktor provokues nga gjykata.

26. Komiteti veren se eshte e mundur te mblidhet i gjithe legjislacioni perkates ne lidhje me anti-diskriminimin. Komiteti inkurajon autoritetet Shqiptare te merren me tej me kete ceshtje duke pasur parasysh, sapo te kompletohen, rezultatet e Rishkimit te Diskriminimit ne baze te Paktit te Stabilitetit per Europen Juglindore, e cila aktualisht po drejtohet nga nje grup ekspertesh te pavarur shqiptare.

27. Ne pergjithesi Komiteti veren me interes se qeveria shqiptare ka ne plan te ngreje nje grup *ad hoc*, i cili perbehet nga perfaqesues qeveritare dhe jo qevritare, per te ripare legjislacionin aktual shqitar ne lidhje me minoritetet kombetare. Komiteti pershendet kete hap ne vecanti pasi mbeten akoma zona specifike te caktuara, te cilat legjislacioni nuk i mbulon. Persa i perket mbrojtjes se personave qe i perkasin minoriteteve kombetare (shih me poshte komentet mbi artikullin 10 dhe 11). Ne kete drejtim Komiteti inkurojon autoritet shqiptare te rishikojne ne nje momet te pershtatshem mundesine per te pergatitur nje ligj specifik per minoritetet te cilat jo vetem do te lejojne autoritetet te plotesojne boshlleqet ne legjislacion por ne te njejten kohe do te krijojne mundesine dhe do te ndergjegjesojne autoritetet shqiptare, politikat dhe angazhimet drejt mbrojtjes dhe nxitjes te te drejtave te personave qe i perkasin minoriteteve ne Shqiperi.

28. Pavaresisht se diskriminimi nuk eshte nje problem madhor ne shoqerine shqiptare, Komiteti eshte i vetedijshem per disa ankesa nga persona qe i perkasin minoriteteve te cilet paraqesin raste diskriminimi ne fusha te ndryshme duke filluar nga punesimi deri tek sherbimet sociale si(uje, elektricitet), arsimim, strehim, sherbime sociale dhe e drejta per pronesi.

Komiteti gjithashtu veren se sipas autoriteteve shqiptare kufizimet (uje, drita), mungesa te sherbimeve baze sociale, jane probleme qe i hasin dhe i perballojne te gjithe shqiptaret. Pa pasur te dhena te sakta statistikore gjithsesi eshte e veshtire qe Komiteti te komentoje nese ky eshte nje problem i pergjithshem. Komiteti nuk eshte aspak i shqetesuar se nje faktor i problemeve, qe ndeshin personat qe i perkasin minoriteteve, eshte perhapja e faktit qe duhet te paguajne bakshish per te plotesuar nevojat e familjes se tyre ose per te fituar disa te drejta te tyre ne sferat e jetes. Komiteti mendon se autoritetet shqiptare duhet te marrin masat e duhura qe t'i shkulin nga rrenjet keto lloj praktikash te cilat cojne ne rritjen e shkalles se diskriminimit direkt apo indirekt te personave qe i perkasin minoriteteve te cilet shpesh ju duhet te paguajne bakshish pasi nuk i perkasin anje lloj tarafi.

29. Komiteti eshte i ndjeshem ne lidhje me raportet e paragjykimit dhe diskriminimit qe has komuniteti rom dhe veren ne kete drejtim se probleme

te ngjashme hasin edhe personat qe i perkasin komunitetit egjiptian.Komiteti mendon se ka nevojte te behet nje monitorim i metejshem i situates dhe nje ndergjegjesim me te madh i saj nga te gjithet, duke perfshire zyrtaret, gjykatesit dhe policine.

30. Komiteti eshte i shqetesuar per rritjen e diferences social-ekonomike qe po krijohet midis romeve dhe pjeses tjeter te popullsiset shqiptare.Kjo ne vecanti ne raste te lidhura me arsimimin, strehimin, punesimin, e drejta per sherbime sociale, per kujdes shendetesor si dhe per problemet baze te jeteses.Me qellim qe te behet nje permbledhje e plote e ketij problemi kerkohen te dhena te sakta statistikore jo vetem per romet por per te gjithet minoritetet ne Shqiperi. Komiteti mendon se mungesa e te dhenave te sakta statistikore mund te pengoje seriozisht mundesine e shtetit per te monitorizuar, zbatuar dhe deshifruar masat e duhura me qellim qe te siguroje barazi te plote dhe efektive ndaj personave qe i perkasin minoriteteve.Pa keto te dhena eshte shume e veshtire te paraqiten politika dhe programe dhe te krijohen mundesi qe trupat monitoruese nderkombetare te konkludojne nese Shqiperia permbush detyrimet e saj qe rrjedhin nga Konventa Kuader. Komiteti keshtu mendon se qeveria duhet te identifikojte menytrat dhe mjetet me efikase per te nxjerre te dhena te sakta statistikore, pavaresisht nga mosha, gjinia dhe vendbanimi(Shih komentet e meposhtme).

31. Komiteti pavaresisht se njeh faktin se autoritetet shqiptare po marrin nje sere masash qe kane te bejne me trajtimin vecanerisht te situates se komunitetit rom, do t'ju ve ne dijeni autoriteteve shqiptare nevojten per te marre ne konsiderate Rekomandimet e Komitetit te Ministrave(2001)17 mbi permiresimin e situates ekonomike dhe te punesimit te romeve dhe egjiptianeve. Komiteti pershendet hapat qe jane marre per vendosjen e nje strategjie kombetare per permiresimin e kushteve te jeteses te romeve nga Zyra Kombetare e Minoritetit ne Ministrine e Puneve te Jashtme Shqiptare. Komiteti inkurajon autoritet shqiptare t'i vazhdojne perpjekjet e tyre ne kete drejtim dhe te krijojne mundesine e konsultimeve te shumta dhe pjesemarrjeve te shumta ne hartimin dhe zbatimin e kesaj strategjie jo vetem ndermjet departamenteve qeveritare por dhe ndermjet perfaqesuesve te shoqerise civile dhe perfaqesuesve te komunitetit rome. Ne kete kontekst Komiteti shpreson se pjesemarrja e grave rome ne keto aktivitete do te sigurohet dhe nje fond perkates do te jepet per kete strategji.

32. Komiteti veren rolin e rendesishem qe mund te luhet nga Organizatat jo Qeveritare dhe nga institucione te tilla si Avokati i Popullit . Ne kete drejtim Komiteti nenvizon punen e bere kohet e fundit nga punonjesit e zyres se Avokatit te Popullit dhe rolin e tyre te fuqishem ne identifikimin dhe luften kunder diskriminimit. Komiteti veren me interes se kjo Zyre ka ekzaminuar

nje numer rastesh te lidhura me minoritetet pavaresisht se asnje nga keto lloj ankesash nuk jane shqyrtuar me tej. Komiteti mendon se Avokati i Popullit duhet te emeruje nje perfaqesues te tij ne Jug te Shqiperise ku eshte nje zone me minoritetet te konsiderueshem grek. Persa i perket rendesise se informimit te njerezve per punen e Avokatit te Popullit, Komiteti pershendet planin e shperndarjes se panfleteve qe permbajne informacion te tille ne gjuhen e minoritetit. Komiteti inkurajon Avokatin e Popullit te vazhdoje pune e tij ne lidhje me minoritetet dhe t'i kushtoje nje rendesi te vecante mundesise se shtrirjes se aktivitetit te tij duke emeruar nje perfaqesues ne Jug te vendit.

#### Artikulli 5.

33. Komiteti keshillues veren nga Raporti i Shtetit, rolin e rendesishem te Organizatave Jo Qeveritare duke perfshire ketu organizatat qe perfaqesojne minoritetet, rolin qe ato luajne ne nxitjen e permiresimit te kushteteve per minoritetet dhe ne ruajtjen e etj.

34. Komiteti Keshillues veren se ndihma e mesiperme eshte mbeshtetur dhe nga qeveria shqiptare, vecanerisht ne nivel lokal, dhe se masa te caktuara direkte jane marre nga autoritetet, perfshire ketu Ministrine e Kultures dhe Rinise, e cila ka financuar nje numer projektesh te paraqitura ne Ministri dhe mbeshtet aktivitetet e Qendres Nderkombatare te Folklorit. Komiteti Keshillues kurre nuk ka mare telefonata nga persona qe u perkasin minoriteteve kombetare per ndonje ndihme te madhe nga autoritetet shqiptare. Komiteti Keshillues mendon se duhen marre iniciativa te metejshme nga qeveria, duke perfshire ketu mbeshtetjen financiare te tyre, ne konsultim me perfaqesuesit e minoriteteve te ndryshme te cilet i marrin keto iniciativa jo ne menyre te njeanshme, ose nga shoqeria civile, ose nga shtetet meme.

35. Komiteti Keshillues eshte i shqetesuar nga raporte se persona te caktuar pretendojne se vllehet jane asimiluar teresisht ne shoqerine shqiptare. Komiteti Keshillues mendon se duhet te merren te gjitha masat e duhura per te parandaluar keto pretendime. Ne kete drejtim Komiteti iu kujton autoriteteve shqiptare rendesine e Rekomandimeve 1333(1997) te Asamblese Parlamentare te Keshillit te Europes mbi kulturen dhe gjuhen e vlleheve, ne vecanti ate te mesimit te gjuhes se tyre anetare duke praktikuar besimin fetar ne gjuhen e tyre si dhe mbeshtetjen per shoqatat kulturore dhe te medias ne gjuhen meme (shih me poshte nga artikulli 9 deri te 14).

## Artikulli 6.

36. Komiteti Keshillues pershendet faktin se ne pergjithesi nje fryme tolerance mbizoteron ne Shqiperi dhe jane shume pak raste te raportuara kercenimesh apo akte diskriminimi, keqtrajtimi apo dhune si rezultat i identitetit etnik, kulturor, linguistik apo fetar.

37. Komiteti Keshillues gjithsesi ka marre informacione te cilat tregojne se personat qe i perkasin minoritetit rom ndeshen me probleme te paragjykimit ne jeten e tyre te perditshme (shihni gjithashtu ne artikullin 4 lart) dhe ka shembuj te paragjykimit dhe stereotipeve negative ne media(shih dhe me poshte artikullin 9). Per me tej sipas gjasave nga burime te ndryshme persona qe u perkasin ketij grupi iu nenshtrohen keqtrajtimeve nga disa oficere te ligjit.

38. Komiteti Keshillues mendon se artikulli 6 eshte i gjere dhe ka hapesine per te konsideruar situaten edhe per komunitetin egjiptian i cili duket se ka te njejtat probleme me keto te komunitetit rom. Kjo ka lidhje me diskriminimin dhe paragjykimin ne nje shkalle te gjere te problemeve sociale qe dalin nga punesimi, nga sherbimet sociale baze, nga portretizime ne media dhe akses ne arsim ku femijet egjiptian duket se kane nivele me te ulta pjesemarrje dhe rezultatesh dhe ndonjehere ata jane objekt tallje ne klasa.

39. Komiteti Keshillues veren gjithashtu nje numer incidentesh keqtrajtimi ndaj minoritetit grek duke perfshire tensionet dhe retorite nacionaliste qe jane shfaqur midis shumices shqiptare dhe minoritetit grek gjate zgjedhjeve lokale ne Himare ne Tetor 2000 si dhe perballimin e nje numer rasteve ne greqisht ne jug te vendit.

40. Duke u nisur nga me lart Komiteti mendon se Qeveria duhet te jete shume e vemendshme per nevojat konstante ne kete zone duke i dhene nje rendesi te vecante problemeve qe perballohen nga komuniteti rom dhe egjipt dhe duhet te jete e gatshme te marre masat e duhura kur dhe ku eshte e nevojshme. Keto masa perfshijne arsimin per te inkurajuar tolerancen dhe ndergjegjesimin per nevojat e ketyre grupeve, vecanerisht nga institucione te tilla si policia , drejtesia dhe media. Ne vecanti marredhenieve me median, Komiteti i referohet parimeve te vendosura ne rekomandin (nr.97) dhe (nr.21) te vendosur nga Komiteti i Ministrave mbi median dhe nxitjen e tolerances dhe te nevojave per nje zbatim te sakte te ketyre parimeve. Persa i perket oficerave te Policise Gjyqesore , Komiteti mendon se funksioni i permiresuar i procesit te ankimit te nje polici, duke perfshire nje proces te pavarur te policise, mund te jete nje menyre efikase per te adresuar akuza te keqtrajtimeve nga ata te policise Gjyqesore gje qe shihet si nje problem i pergjithshem ne Shqiperi dhe qe ka ndikimin e tij mbi minoritetet .

41. Komiteti është gjithashtu i shqetësuar, në vecanti përsa i përket marrjes së informacioneve mbi trafikimin e femijëve dhe të vajzave që i përkasin komunitetit rom dhe atij egjiptian. Komiteti mendon se kjo është një çështje që autoritetet shqiptare duhet ta investigojnë thellë si një çështje e një prioriteti të rëndësishëm në bashkëpunim me komunitetet e lidhura me këto probleme me qëllim eliminimin e këtyre trafikimeve.

#### Artikulli 7

42. Komiteti përshendet faktin se më 17 shkurt 2000 është aprovuar një ligj mbi Partitë Politike (Ligji nr.8580) i cili ka hyrë në fuqi duke hedhur poshtë ligjin no.7502(25 07.1991) i cili parandalon minoritetet për të pasur partitë e tyre politike (shih artikullin 15 më poshtë).

#### Artikulli 8

43. Komiteti ka marrë informacion për vështirësitë që hasin minoritare të caktuar në lidhje me kthimin e pronave të kishave duke përmbledhur këtu tokat që i rrethojnë kishat. Në këtë drejtim Komiteti ve re në vecanti pretendimet e minoritetit grek dhe atij vllah. Komiteti është në dijeni se Shqipëria si shumë vende të tjera në rajon ka patur probleme me kthimin e pronave sidomos me kthimin e pronave të kishave dhe mendon se autoritetet duhet të kenë shumë kujdes në këtë proces të kthimit të pronave dhe të vendosin një balance të drejte dhe të kujdesshme midis interesave të të gjithë të interesuarve. Komiteti mendon se kjo politike duhet të zbatohet pa asnjë lloj forme diskriminimi që ndikojnë mbi persona që i përkasin minoriteteve.

#### Artikulli 9

44. Komiteti mendon se liria e shprehjes është e garantuar në baze të nenit 22 të Kushtetutës së Shqipërisë dhe se e Drejta e Shtypit në baze të Amendamentit nr. 8239 i datës 3 shtator '97, ka vetëm një nen që thotë "Shtypi është i lire dhe liria e shtypit respektohet me ligj". Komiteti gjithashtu ve re se ligji nr. 8410 i datës 30 shtator 1998 "Mbi Televizionet dhe Radiot private dhe publike të Republikës së Shqipërisë", u garanton minoriteteve akses për Media elektronike duke lejuar përdorimin e gjuhës së tyre të minoritetit në baze të nenit 37. Komiteti ve re se nuk ka ndonjë limit në raportin e dhenies së lajmit ose informacionit në gjuhën e minoritetit.

45. Komiteti mendon se ka akoma hapesire per te bere ndryshime persa i perket kuadrit legjislativ te medias. Ne kete drejtim Komiteti ve re se nje draft eshte pergatitur “Mbi ligjin e Lirise se Shtypit”, por nuk u pasua me tej me verejtje apo me komente si ne plan te mbrendshem ashtu edhe ne ate nderkombetar. Per me tej Komiteti kupton se nje draft i ri mbi televizionin po pergatitet ne nje te ardhme te afert. Komiteti e quan te rendesishem adoptimin e nje legjislacioni ne kete fushe per te pasur lehtesira te aksesit per media te personave qe i perkasin minoriteteve ne perputhje me nenin 9 paragrafi 2 te Konventes Kuader dhe inkurajon autoritetet qe te sigurojne se nje konsultim adekuat duhet bere me te interesuarit, duke perfshire ketu minoritaret, ne pargatitjen e ketij legjislacioni.

46. Ne raport me median e shkruar Komiteti veren se personat qe i perkasin minoriteteve ne Shqiperi kane median e tyre te shkruar, pavaresisht se e kufizuar, dhe nje pjese e mire e saj botohet regullisht por nuk ka gazeta te perditshme shqiptare ne gjuhen e minoriteteve per ato qe u perkasin ketyre minoriteteve. Komiteti veren se pavaresisht se media e huaj eshte e pranishme ne vend ne disa gjuhe te minoriteteve, dhe pavaresisht se mundesia e shtetit per asistencë ndaj medias, ne nje forme apo nje tjetër mund te jete e kufizuar, autoritetet duhet te mendojne se si te mbeshtesin median e minoritetit.

47. Ne lidhje me programet e radios dhe televizionit, Komiteti mendon se eshte nje numer i kufizuar programesh per minoritetet si per shembull nje program 30 minutash nga Radio Tirana ne gjuhen greke, dy here ne dite, nje program 45 minutesh cdo dite dhene nga radio Gjirokastra, lajme ne maqedonisht dhene nga radio-Korca tre here ne jave, por nuk ka programe ne gjuhen e minoriteteve rome, vllah dhe malazeze. Per me tej nuk ka stacione televizive apo radio qe kujdesen vetem per minoritetet.

48. Ne lidhje me radiot dhe televizionet private , Komiteti ve re se nuk eshte bere asnje kerkese nga Keshilli i RTV-se per licensa per instalimin e stacioneve lokale te radiove dhe televizioneve. Komiteti kupton se kjo mungese kerkese eshte si rezultat i mungeses se fondeve me shume sesa mungese e interesave te minoritareve.

**49. Komiteti mendon se ka akoma hapesire per te zgjeruar programet televizive per minoritetet dhe eshte i ndjeshem ndaj thirrjeve per te rritur nivelin e mbulimit te problemeve te minoriteteve me nje numer me te madh programesh televizive ne gjuhe te ndryshme te minoritareve si per radiot dhe televizionet. Komiteti mendon se nje ndihme me te madhe ne kete drejtim duhet te japin autoritetet perkatese. Per shembull duke kerkuar licensa per instalimin e nje kohe te caktuar te programeve ne gjuhen e minoritetit dhe ngritja e nje Keshilli mbikqyres i RTV-se ku te kete dhe nje perfaqesues te**

minoriteteve qe duhet te kontrolloje ose te mbikqyre raportin e programeve qe i perkasin minoritareve si dhe kohen dhe programimin e tyre per te garantuar nje pasqyrimin te sakte te minoriteteve respektive.

50. Komiteti pershendet hapat e ndermarre nga autoritete lokale se bashku me vendimet perkatese te Keshillit mbikqyres per lejimin e instalimit e amplifikatoreve te televizionit qe lejojne ose krijojne mundesi per minoritetin grek te ndjeke programet greke te perfshira ne Tirane. Komiteti mendon se edhe minoriteti maqedonas dhe malazes mund te marrin programe te caktuara televizive ose te radios nga vende fqinje pa ndonje amplifikator te vecante. Komiteti e pershendet kete situatë dhe mendon se mundesimi i programeve te tilla nga shtete fqinje nuk duhet te zbehe mundesine e sigurimit te programeve ne vend, persa i perket minoritetit dhe programeve ne gjuhen e tyre.

51. Komiteti mendon se trajtimi dhe sensibilizimi i gazetareve dhe i profesionisteve te medias per situaten e minoriteteve ne Shqiperi mund t'i hape rruge rritjes se nivelit cilesor te trajtimit te ceshtjeve minoritare pergjithesisht ne media. Komiteti keshtu inkurajon autoritete perkatese qe se bashku me gazetaret dhe profesionistet e medias te verifikojne ose ekzaminojne se si trajnime apo ndergjegjesime te tilla mund te realizohen. Per kete Komiteti mendon se nje kujdes i vecante duhet t'i jepet problemeve te lidhura me romet se sic thuhet ka nje injorim te madh nga media per ta dhe se akoma ekzistojne steriotipe negative nga media, per persona qe i perkasin ketij grupi.

## Artikulli 10

